



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

01-963



Në bazë të dispozitave të nenit 21,22 dhe 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 3 dhe 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-109420/23 dt.30.05.2023, të pronarit, Ramadan Mehani, rr. Nazim Gafurri nr.197 të lagja “Taslixhe”, në Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale në themele të vjetra, në kuadër të PZHU-së, Drejtoria e Urbanizmit Komuna e Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 04.03.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore Ramadan Mehani nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-109420/23 dt.30.05.2023, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, në themele të vjetra, me etazhitet S+P, në kuadër të PZHU-së në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 5246-0 ZK Prishtinë.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “Ndërtim individual”.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
Numri i parcelës kadastrale është 5246-0, me S=204 m² e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-05246-0, si tokë ndërtimore.
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në parcelën kadastrale për të cilën lëshohen këto kushte të ndërtimit, ekziston shtëpia e banimit, me etazhitet S+P, e ndërtuar, sipas Aktvendimit, 07-361-158 dt.09.08.1990, të lëshuar nga Sekretariati i Urbanizmit, Punëve Komunale dhe Banesore i Komunës së Prishtinës;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka ramje prej Veri-Jug.
- Parcela ka qasje direkte në rrugën publike ekzistuese në terren.
- Në diametër prej 50 m' ka ndërtesa të ndërtuara dhe destinimi i tyre është banim individual.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin – ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, në themele të vjetra, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;

ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas llogarive dhe projekt propozimit, si në vijim:

Ndërtesë individuale banimore/shtëpi familjare

Shtëpi banimi $S=129.40 \text{ m}^2 / 91.80 \text{ m}^2$, mbi tokë + 30.60 m^2 , nëntokë /,
Etazhitet: S+P

- Distanca në mes të vijës rregulluese dhe asaj ndërtimore të jetë 5.00m;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas paternave të rrethinës, të jetë për "Banim individual".
- Etazhiteti është i propozuar dhe i miratuar, është sipas gjendjes ekzistuese, S+P;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore-brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës ose suterren, sipas PZHU-së, është $0.2 (20\%) \div 0.3 (30\%)$, dhe sipas llogarive kjo sipërfaqe është:
 $S=204 \times 0.2 \div 0.3 = 40.80 \div 61.20 \text{ m}^2$ / sipas PZHU-së /,
 $S=78.53 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit dhe gjendjes ekzistuese, në themele të vjetra /;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës (ISHPN), për vendosjen e shtëpisë në bazë-gabarit të bodrumit është max. 60%, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, me kushtin që pjesa e nëntokës që shtrihet jashtë gabaritet, nuk mund të tejkalojë nivelin e truallit, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:
 $S=204 \times 0.6 = 122.00 \text{ m}^2$ / sipas PZHU-së /,
 $S=0.00 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /;
- Koeficienti i minimal të parcelës kadastrale - parcelës ndërtimore, për hapësira gjelbëruese (ISHPGJ) është min. 40%, bazuar në Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe kjo sipërfaqe do të jetë:
 $S=204 \times 0.4 = 81.60 \text{ m}^2$ / sipas Vendimit të Kryetarit /,
 $S=204 \times 0.3 = 70.20 \text{ m}^2$ / sipas Vendimit të Kryetarit /,
 $S=85.29 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /,
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Zhvillimor Urban-PZHU, është $0.6 \div 0.8$. Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - *suterren*, dhe **0%** për etazhet e nëntokës.
 $S=204 \times 0.6 \div 0.8 = 122.40 \div 163.20 \text{ m}^2$ / sipas PZHU-së /,
 $S=129.40 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /;
- Distancat nga kufiri i parcelës, për ndërtimin e shtëpisë në themele të vjetra, sipas situacionit të bashkangjitur këtij vendimi;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2015 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Qasja në parcelë të jetë nga rruga ekzistuese;
- Për shtëpitë individuale të banimit, duhet të sigurohet 1 vendparkim;
- Në paraqitjen e situacionit të parcelës kadastrale, të paraqiten edhe organizimi i vendparkimeve të jashtme, rrugëve përreth parcelës, gjelbrimit të planifikuar, etj.;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efikasitetit të energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara dhe kushteve të objekteve ekzistuese dhe rrethinës.
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Të bëhet aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuara në kriteret dhe parametrat urban të PZHU-së, si dhe me normat dhe standardet tjera të planifikimit.

V. **Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI. **Dokumentacioni ndërtimor** - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe paralogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme;

VII. **Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtorja e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);

e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01-0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Paguesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

IX. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Aplikuesi/pronari, Ramadan Mehani nga Prishtina, me kërkesën 05 nr.350/02-109420/23 dt.30.05.2023, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, në themele të vjetra, me etazhitet S+P, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr.5246-0 ZK Prishtinë, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-05246-0.
- Incizimin gjeodezik, punuar nga gjeodeti i licencuar Arsim Osmani nga Prishtina, me numër të licencës 203;
- Çertifikata e biznesit ARBK nr.812023521 e dt.13.03.2023 “KrsAs Architecture”, SH.P.K
- Aktvendimi i Lejes ndërtimore Vendim i lëshuar nga sekretariati për Urbanizëm Punë Komonale dhe Banesore, Komuna e Prishtinës nr.07-361-158 dt.29.08.1990, në emer të Vasic Miroslav;
- Vendim me nr.06-297 dt.13.05.1969 lëshuar nga Sekretariaji për Urbanizëm Prishtinë, për ndërtesën shtëpi banimi me dimensione 5x12m, dhe aneksin me dimnzione 6x6m;
- Kopjen e planit nga Arihiva Komonale në Prishtinë, është e skicuar ndërtesa e shtëpisë nividuale me sipërfaqe 115m², e vertetuar me nr.03/196 dt.16.05.2023;
- Projekti ideor konceptual i punuar me Çertifikatë të biznesit ARBK nr.812023521 e dt.13.03.2023 “KrsAs Architecture”, SH.P.K.;
- Inçizimi gjeodezik i gjendjes faktike në teren i ndërtesës ekzistuese me etazhitet S+P, i punuar nga Arsim Osmani nga Prishtina, me numër të licencës 203;
- Fotot e lokacionit.

Drejtorja e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesës 109420/23 dt.30.05.2023, shqyrtimit të përmbajtjes së saj dhe të lokacionit, për të cilën kërkohet përcaktimi i kushteve ndërtimore, dokumentacionet e bashkëngjitura me kërkesë dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës administrative, konsultoi dokumentet e planifikimit hapësinor për lokacionin ku shtrihet parcela - Plani Zhvillimor Urban, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, projekt propozimin-projektin konceptual me “zgjidhja urbane” dhe projektin ideor, dhe procedurat e zhvilluara gjatë fazës së procedimit administrativ, në mënyrë procedurale dhe kronologjike, konstatoi se:

Parcela kadastrale nr. 5246-0 ZK Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 204 m² sipas certifikatës së njësisë kadastrale, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban – PZHU-së, në Prishtinë, dhe sipas këtij plani është me destinim “Ndërtim individual”, dhe i cili njëherit është destinim i propozuar nga aplikuesi.

Kjo drejtori, paraprakisht marrjes së vendimit përfundimtar, konkretisht në procedurën e shqyrtimit të kërkesës së referuar më lartë, duke u bazuar në nenin 18 të Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, dhe pikës 1.2 dhe 1.2.2 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për Caktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, me datë 31.01.2024, ka vendosur njoftimin publik

në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej 50m², për të njoftuar publikun me synimin e bashkëpronarëve për ndërtim, dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre për 5 (pesë) ditë, për t'ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komentëve. Ky njoftim publik ka vazhduar të qëndrojë deri me datën 04.02.2024, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare të kësaj drejtorie nuk ka arritur asnjë vërejtje apo sygjerim.

Kjo drejtori, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës së lartshënuar, ka konstatuar se me kërkesën e njëjtë aplikuesi ka kërkuar caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, në themele të vjetra, me etazhitet S+P, në parcelën kadastrale nr. 5246-0 ZK Prishtinë. Pas shqyrtimit dhe analizimit të projekt propozimit-projektit konceptual me “zgjidhja urbane”, dhe në manualin e incizimit gjeodezik, është konstatuar se në kuadër të parcelës kadastrale në trajtim, gjendet e ndërtuar ndërtesa individuale banimore-shtëpia e banimit, me etazhitet S+P, sipas Aktvendimit, 07-361-158 dt.09.08.1990, të lëshuar nga Sekretariati i Urbanizmit, Punëve Komunale dhe Banesore i Komunës së Prishtinës. Sipas projektit konceptual, kushtet ndërtimore janë propozuar për ndërtimin e ndërtesës individuale banimore-shtëpi banimi, në themele të vjetra, me sipërfaqe të përgjithshme S=129.40 m².

Andaj, kjo drejtori, pas analizimit të projekt propozimit konceptual dhe krahasimit të tij në raport me parametrat urban të përcaktuar me dokumentin e planifikimit hapësinor-PZHU-në, ka konstatuar se i njëjti është hartuar në harmoni me parametrat e përcaktuar, dhe duke vepruar konform rregullativës ligjore në fuqi, përkatësisht nenit 3, paragrafi 1.5, nënparagrafi 1.5.4, të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, vendosi të miratojë kërkesën për caktim të kushteve ndërtimore për ndërtimin e ndërtesës individuale banimore-shtëpi banimi, në themele të vjetra.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të parcelës kadastrale në rrugën e lokale/rrugën publike, ku ndër të tjera konstatohet :

Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Ramadan Mehani, në Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-109420/23 dt.30.05.2023, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese “Nazim Gafurri”, për ndërtesën banimore - shtëpi individuale me etazhitet S+P, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e till, marrë parasysh edhe gjendjen faktike të rrugës ekzistuese në raport me parcelën 5246-0 Zk. Prishtinë. Kyçja duhet të përshtatet teknikisht rrugës ekzistuese, dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes.

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 3 dhe 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe nenin 13 të “Udhëzim Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit-“zgjidhja urbane”, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i Situacionit – “Situacioni i ngushtë”,

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.


Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesit, në dosje të lëndës 05 Nr.351/02-109420/23 dt.30.05.2023, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR.350-/02-109420/23 dt.04.03.2024

Zyrtari,
Gëzim Perizi

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



A	⊕	
Projektat: Kras Architecture SH.P.K Ark. Gazim Krasniqi		

PROJEKTI IDEORË

Emërtimi i Objektivit:
Objekti Shtëpi individuale S+P

Lokacioni: Rr.Nazim Gafurri
 ZK - Pishinë

Nr.1 Parcelës:
 05246-0

Investitorë:

Faza e Projektit:
ARKITEKTURA

Pëmbajtja e Fletës:
SITUACIONI

Periudha e Projektimit:
 2023

Perpjësja:
 1:100

Formati:
 A3

Nr.1 Fletës

Rr.Nazim Gafurri

Vija rregullative

Vija ndertimore egzistuese